Conference speakers addressed issues arising from the need for sustainable harvesting of the aromatic and medicinal natural resources as a base for the present and future of the industry in Albania. The EPCA chairmen, Mr. Xhevit Hysenaj, emphasized the challenges faced by the industry mentioning inappropriate harvesting as one of the main problems that diminishes the quality of the finished products and jeopardizes plant regeneration. EDEM Herbs and Spices Business Development Specialist, Ms. Eva Bazina, highlighted the industry's achievements from recent years including the successes in development and marketing of new value added products, the use of advanced technologies, adoption of international quality standards, and the increase of commercial cultivation.

Mr. Sajmir Hoxha, Advisor to the Minister of Environment, Forests and Water Management, spoke about the symbiotic relations between government and the industry and emphasized that sustainable harvesting has social, ethical and tourism implications. Mr.Hoxha assured that the ministry, which is responsible for managing the public lands used for wild crafting, will increase it's collaboration with the industry.

In her presentation Mrs. Liri Dinga, Director of the Botanical Garden of Albania, addressed the status of some herbal spices that are presently traded for export; and also proposed ways for their monitoring and protection. Mr. Agim Shehu, the head of World Bank Agricultural Services Program, highlighted the donor support his institution was providing in assisting in commercial cultivation activities and further processing of raw herbs and spices to the benefit of rural communities.

2nd National Conference of the Herbs and Spices Industry / *Konferenca e Dytë Kombëtare e Industrisë së Bimëve Aromatiko-Mjekësore*

Referuesit në konferencë trajtuan çështje që dalin prej nevojës për shfrytëzimin me kriter të burimeve natyrore të bimëve aromatiko-mjekësore, si themeli për të tashmen dhe të ardhmen e kësaj industrie në Shqipëri. Kryetari i EPCA-s, z. Xhevit Hysenaj, theksoi sfidat me të cilat përballet kjo industri, ku përmendi vjeljen pa kriter, si një prej problemeve më të mprehta që çon në ulje të cilesisë së produkteve përfundimtare dhe rrezikon rigjenerimin e bimëve. Specialistja e EDEM për Zhvillim Biznesi të Bimëve Aromatiko-Mjekësore, zj. Eva Bazina, nënvizoi arritjet e industrisë në këto vitet e fundit, që përfshijnë suksese në zhvillimin dhe marketimin e produkteve të reja me vlerë të shtuar, futjen e teknologjive të avancuara të përpunimit, zbatimin e standarteve ndërkombëtare të cilësisë dhe kultivimet komerciale në rritje.

Z. Sajmir Hoxha, Këshilltar pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, foli rreth marrëdhënieve simbiotike ndërmjet strukturave shtetërore dhe industrisë, si dhe theksoi që vjelja me kriter ka ndikim në aspektin social, etik dhe në turizëm. Z. Hoxha siguroi që ministria, e cila është përgjegjëse për manaxhimin e tokave publike të shfrytëzuara për grumbullimin e bimëve të egra, do të rrisë bashkëpunimin e saj me industrinë. Në prezantimin e saj, znj. Liri Dinga, Drejtore e Kopshtit Botanik të Shqipërisë, trajtoi statusin e disa specieve aromatiko-mjekësore që aktualisht tregtohen për eksport, si dhe propozoi rrugë për monitorimin dhe mbrojtjen e tyre. Z. Agim Shehu, Drejtor i Programit të Shërbimeve Bujqësore të Bankës Botërore përmendi mbështetjen donatore që institucioni i tij ka dhënë në ndihmë të aktiviteteve kultivuese, si dhe përpunimit të mëtejshëm të lëndës së parë në përfitim të komunitetit rural.

The conference was concluded with the idea of creating a working group to initiate discussion with government in order to improve the business environment for this industry. The issues that surround this industry and the interests of the different stakeholders require a search for common ground in order to revive this economic activity that is a significant source of income to thousands of Albanian rural families. ■

Konferenca konkludoi me idenë e krijimit të një grupi pune, i cili do të fillojë bisedimet me institucionet shtetërore, me qëllim përmirësimin e mjedisit të biznesit për këtë industri. Problematika që has kjo industri, si dhe interesat e kompanive të ndryshme kërkojnë gjetjen e mënyrave për një qëllim të përbashkët - rigjallërimin e këtij aktiviteti ekonomik, i cili është një burim i rëndësishëm të ardhurash për mijëra familje rurale në Shqipëri. ■

Albanian Herb and Spice Products to the US Market

Agroherbal, based in Mamurras, recently completed its first ever export sale of Albanian herbs and spices to a California firm. The sale, a full container's worth, was made with support from EDEM. EDEM helped screen the interest of the US buyer, introduced the buyer to Agroherbal, advised the company on its communication with the buyer and supported the company's efforts to meet international standards of quality, packaging and labeling of the final products.

Agroherbal is engaged in the collection and processing of a wide range of herb and spice products (a total of 150 items), and is focused on producing high quality products and providing top quality service to its customers. ■

Shtohet Prezenca e Produkteve Aromatiko-Mjekësore Shqiptare në Tregun Amerikan

Agroherbal, me aktivitet në Mamurras, realizoi kohët e fundit për herë të parë eksport të disa bimëve aromatiko-mjekësore tek një kompani në Kaliforni, USA. Eksporti, me vlerën e një konteineri plot, u krye me ndihmën e EDEM. Projekti ndihmoi në identifikimin e blerësit amerikan, vuri në kontakt palët e interesuara, këshilloi kompaninë furnitore shqiptare në komunikimet e vazhdueshme me blerësin amerikan dhe ndihmoi përpjekjet e Agroherbal në përmbushjen e standarteve ndërkombëtare të cilësisë, paketimit dhe etiketimit të produkteve përfundimtare.

Agroherbal është i specializuar në grumbullimin dhe përpunimin e një game shumë të gjerë bimësh aromatiko-mjekësore (rreth 150 artikuj) dhe është i fokusuar në furnizimin e produkteve dhe ofrimin e shërbimeve sa më cilesore tek klientët e tij. ■

Meat Processing Industry

Packaging Technologies Minifair

Albanian meat and milk processors increasingly realize that the ability to adopt contemporary packaging technologies and concepts makes a huge difference in the success of their sales efforts.

German and Albanian suppliers of food processing and packaging technologies and materials - Multivac, Weber, ES Plastic, Sudpack and AL-Mar - presented new vacuum packaging machines and materials at the recently held Packaging Technologies Mini Fair Tirana 2006. Held at Hako Shpk meat processing company, more than 15 companies from the meat and milk processing industries were exposed to the latest trends and technological solutions in vacuum packaging.

The availability of Multivac food vacuum packaging technologies to the Albania market in 2005 resulted in major improvements in the shelf life and presentation of locally produced products. Representatives of German packaging materials manufactures Südpack and ES Plastic along with Albanian company Al-Mar Shpk introduced new plastic packaging materials that will be launched soon in the Albanian market.

This mini fair and presentations was supported and promoted to the food processing industry by ADAMA and EDEM. ■

Industria e Përpunimit të Mishit

Minipanair për Teknologjitë e Paketimit

During the Mini-Fair of Packaging Technologies / *Gjatë mini-Panairit tëTeknologjive të Paketimit*

Përpunuesit shqiptarë të mishit dhe qumështit e kanë tashmë shumë të qartë që aftësia për të adoptuar konceptet dhe teknologjitë më bashkëkohore të paketimit përbën ndryshim kolosal në suksesin e tyre me shitjet.

Kompani gjermane dhe shqiptare të teknologjive të paketimit ne fushen e përpunimit të ushqimit - Multivac, Weber, ES Plastic, Sudpack dhe AL-Mar – prezantuan në Minipanairin për Teknologjitë e Paketimit të zhvilluar së fundmi në Tiranë, makineri dhe materiale të reja të paketimit me vakum. Në aktivitetin e organizuar në ambientet e kompanisë së përpunimit të mishit Hako Shpk, u demostruan për mbi 15 kompani të përpunimit të mishit dhe qumështit tendencat dhe teknologjitë më të fundit për paketimin me vakum.

Prezenca e teknologjisë së paketimit me vakum të Multivac në tregun shqiptar në vitin 2005 ka rezultuar në përmirësime të ndjeshme në jetëgjatësinë e qendrueshme dhe mirë prezantimin e produkteve që prodhohen në vend. Përfaqësues të kompanive gjermane të prodhimit të materiale të paketimit Südpack dhe ES Plastic, si edhe kompania shqiptare Al-Mar Shpk prezantuan materiale të reja paketimi plastik, që do të hidhen së shpejti në tregun shqiptar.

Minipanairi dhe prezantuesit në të u mbështetën dhe u promovuan për industrinë ushqimore nga ADAMA dhe EDEM. ■

Meat Master Expands to Kosovo Markets

Meat Master, a Shkodra-based meat processing company, has recently made a major move into the Kosovo market. Although Meat Master has had a small presence in Kosovo since 2002 that presence was under constant attack due to fierce competition with exporters from other countries. Not to be dismayed, Meat Master persevered in its efforts to penetrate the Kosovo market and was recently rewarded for its efforts with a long term contract signed to supply a major Kosovo importing/ distribution company. The Kosovo company supplies a network of hundreds of outlets throughout the country and has a long experience serving both the Albanian and Serbian populations.

Meat Master began with a trial shipment in March, which was met with great success and led to the long-term contract. Meat Master presently exports about 12 tons per month of salami and sausages. The company's objective is to increase its exports to Kosovo to 200 tons annually.

Having met with success in Kosovo, Meat Master is now turning toward the possibilities of expanding into Macedonia and Montenegro. However, the food safety and veterinary barriers imposed by these countries to foreign products remain a challenge that needs to be overcome. EDEM is assisting Meat Master to gather updated information on customs requirements and the regulatory procedures that need to be met in order to gain entrance to these countries' markets. ■

Meat Master Zgjerohet në Tregjet e Kosovës

Kompania e përpunimit të mishit Meat Master në Shkodër, ka ndërmarrë kohët e fundit një hap të rëndësishëm me futjen në tregun kosovar. Megjithëse Meat Master ka qenë pak i pranishëm në Kosovë që prej vitit 2002, ka hasur presionin e vazhdueshëm të konkurencës prej eksportuesve nga vende të tjera. Pvarësisht nga kjo Meat Master vazhdoi përpjekjet për të hyrë në tregun kosovar, të cilat së fundmi u shpërblyen me lidhjen e një kontrate afatgjatë furnizimi me një kompani të madhe kosovare shpërndarje/ importi. Kompania kosovare furnizon një rrjet prej qindra dyqanesh në të gjithë vendin dhe ka eksperiencë të gjatë në furnizimin e popullatës shqiptare dhe asaj serbe.

Në mars Meat Master realizoi një ngarkesë provë, që ishte e suksesshme dhe solli një kontratë afatgjatë. Meat Master aktualisht eksporton rreth 12 tonë sallame dhe salçiçe në muaj. Objektivi i kompanisë është të rrisë eksportet në Kosovë deri në 200 tonë në vit.

Nisur nga suksesi në Kosovë, tani Meat Master shqyrton mundësinë e shtrirjes në Maqedoni dhe Mal të Zi. Megjithatë, barrierat e sigurisë ushqimore dhe veterinare të vendosura nga këto vende mbi produktet e huaja përbëjnë një sfidë që duhet kapërcyer. EDEM po ndihmon Meat Master në mbledhjen e informacionit mbi kërkesat doganore dhe procedurat që duhen përmbushur, që kompania të hyjë në këto tregje. ■

EU Regulation: Food Safety Standards in Food Processing

Numerous food safety regulations, legislation and commission decisions lay down conditions that apply in licensing non EU countries and their meat processing businesses before they are allowed to enter products of animal origin in EU markets. The responsibility for this area is within the Health and Consumer Protection Directorate General of the EU. The path for a food processing plant in Albania to obtain approval to export to EU member countries goes through the Albanian national food safety assurance and control process.

In deciding upon requests for export of animal-based food products to the EU, EU authorities rely on the exporting country's legislation, institutions involved in food safety assurance and how well the regulations are implemented. Before an individual food processing establishment from Albania is allowed to export evaluations need to be completed of the animal and public health situation, the official services, the legal provisions, the control systems and production standards in Albania.

Standards in Albanian meat processing plants must be at least equivalent to the requirements of relevant EU legislation. These standards are the same as those applied to member states. The Albanian national veterinary authorities must be confident that the factory standards are met before a company is put forward to the EU Commission for approval. If the Albanian authority does not do its job and approves substandard produced products, this will reflect unfavorably on the authority's ability to continue as the EU in-country watchdog.

Particular attention must be paid to the installation and operation of procedures based on HACCP principles, microbiological controls and an effective official control system, including documented records of control actions and their outcome. As of 1 January 2006, the implementation of HACCP based control systems are mandatory for EU countries in all food production, processing and distribution establishments (except for establishments involved in primary production).

To avoid any conflict of interest and possible fraud, officials in processing plants must be able to act independently of operators. There must be supervisory systems over these officials at regional and central levels. As a general principle, businesses must meet EU standards during EU production runs, however they may meet other standards for their own national markets but such product must be kept strictly separate from product destined for the EU. In all cases, this issue should be clarified during inspection visits by the Food and Veterinary Office.

For more information please see the website http://ec.europa.eu/food/international/trade/guide_thirdcountries2006_en.pdf. ■

Rregulloret e BE: Standartet e Sigurisë në Përpunimin e Ushqimeve

Një sërë rregulloresh të sigurisë ushqimore, ligjesh dhe vendimesh të komisionit përcaktojnë kushtet e liçensimit të vendeve jo anëtare të BE dhe kompanive të përpunimit të mishit të këtyre vendeve për futjen e produkteve me origjinë shtazore në tregjet e BE. Përgjegjësia në këtë fushë i takon Drejtorisë së Përgjithshme të Shëndetit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të BE-së. Rruga që duhet të ndjekë një kompani shqiptare përpunimi të ushqimit për të marrë aprovimin për të eksportuar në vendet anëtare të BE kalon nga zbatimi i sigurisë ushqimore dhe procesi i kontrollit në nivel kombëtar.

Për të vendosur për kërkesat për eksport të produkteve ushqimore me bazë mishi në vendet e BE-së, autoritetet e BE-së mbështeten tek legjislacionin i vendit eksportues, institucionet e përfshira në garantimin e sigurisë ushqimore dhe mënyrën e zbatimit të rregullave. Përpara se një kompani shqiptare e përpunimit të ushqimit të lejohet të eksportojë, duhen bërë vlerësime mbi situatën e shëndetit publik dhe atë të kafshëve, shërbimet zyrtare, masat ligjore, sistemet e kontrollit dhe standartet e prodhimit në Shqipëri.

Standartet ne fabrikat shqiptare të përpunimit të mishit duhet të jenë të paktën të barazvlefshme me kërkesat e legjislacionit të BE-së. Këto standarte janë të njëjta me ato që zbatohen nga vendet anëtare. Autoritetet kombëtare shqiptare veterinare duhet të jenë të sigurta që standartet e fabrikës janë plotësuar përpara se nje kompani të dërgohet për aprovim nga Komisioni i BE-së. Nëse autoritetet shqiptare nuk e kryejnë punën e tyre siç duhet dhe aprovojnë produkte të prodhuara nën standart, kjo do të cënojë aftësinë e autoritetit për të vazhduar punën si palë vëzhguese e BE-së.

Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar vënies në punë dhe zbatimit të procedurave të bazuara në parimet e HACCP, kontrolleve mikrobiologjike dhe një sistemi institucional efektiv kontrolli, që përfshin regjistrim të dokumentuar të veprimtarisë kontrolluese dhe rezultateve të tyre. Që nga 1 janar 2006, zbatimi i HACCP për vendet e BE-së është i detyrueshëm për të gjitha njësitë përpunuese, prodhuese dhe shpërndarëse të ushqimeve (përveç njësive të përfshira në prodhimin primar).

Për të shmangur konfliktet e interesave dhe mashtrimet, në fabrikat përpunuese përfaqësuesit zyrtarët duhet të veprojnë në mënyrë të pavarur nga pronarët. Këta zyrtarë duhet të jenë nën një sistem mbikqyrës në nivel rajonal dhe qendror. Si parim i përgjithshëm, bizneset duhet të zbatojnë standartet e BE-së për produktet që do të eksportohen në BE, sadoqë ato mund të plotësojnë standarte të tjera të zbatueshme për tregun e brendshëm, por këto produkte duhet mbahen rreptësisht të ndara nga produktet e destinuara për tregjet e BE-së. Në të gjitha rastet, kjo çështje duhet qartësuar gjatë vizitave të inspektimit nga Drejtoria Kontrollit Veterinar dhe të Ushqimit.

Për më shumë informacion, mund vizitoni: http://ec.europa.eu/food/international/trade/guide_thirdcountries2006_en.pdf. ■

Leather/Shoes Industry

EDEM Assists BertToni in Winning World Bank Grant

Paulin and Filomena Radovani Berttoni's owners / *Pronarët e kompanisë Berttoni, Paulin dhe Filomena Radovani*

USAID's work in the footwear industry has paid off in a big way for the Albanian company BertToni and for its newly employed workers in the rural Puka region.

Mr. Paulin Radovani, the owner of Shkodra based company, BertToni is one of the pioneers of the Albanian footwear industry. He built his firm from very little only to see it collapse during the troubles in 1997. Through hard work he has rebuilt it and now is among the largest and most successful companies in all of Albania.

To expand his business, he expressed his desire to locate a new footwear operation in the region of Puka, where he obtained some property. The unemployment rate for women in this region is over 90%. He was willing to make an investment but needed additional support if he was to get his plans off the ground. To EDEM, the potential positive impact on the region seemed to be one which would qualify for a grant that the World Bank was offering for outstanding projects in the Balkans. The grant would allow Radovani to leverage his own funds and go forward with the project immediately.

EDEM worked closely with Radovani, assisting in the

Industria e Lëkurë/Këpucëve

EDEM asiston BertToni të Fitojë Grantin e Bankës Botërore

Mbështetja e USAID për industrinë e këpucëve ka "shpërblyer" kompaninë BerToni në Shkodër dhe të sapo punësuarit në zonën e Pukës.

Z. Paulin Radovani, president i BertToni, është një nga pionierët e industrisë moderne shqiptare të këpucëve. Ai e krijoi gjithshka nga fillimi, për ta parë fabrikën të shkatërrohej në trazirat 1997-tës. Me punë dhe përkushtim ai e ringriti atë dhe sot është një nga kompanitë më të mëdha dhe më të suksesshme në Shqipëri.

Për të zgjeruar biznesin, z.Radovani mendoi të krijonte një linjë të re prodhimi këpucësh në Pukë, ku ai disponon edhe disa ambjente. Në zonën e Pukës shkalla e papunësisë për femrat arrin në 90%. Që ta fillonte investimin nga fillimi i duhej mbështetje. Për EDEM, ndikimi pozitiv potencial në këtë zonë e bënte më të mundshëm kualifikimin për marrjen e grantit të ofruar nga Banka Botërore për projekte të vlefshme

Worker Training has Begun in Puka / *Fillon trainimi i punëtorëve në Pukë*

preparation of the project proposal documents and explaining in detail the impact this project could have on the unemployed women in Puka. The first step in the grant award process was going against competition from other worthy projects from within Albania. The case made was compelling in Albania and Radovani was one of a select few who made the cut to go onto regional competition in Belgrade. Competing against over 120 projects from throughout the Balkans, BertToni was one of 21companies whom the World Bank selected to receive a $35,000 grant!

During the journalist event to BertToni in May, Radovani took time from his discussion of the footwear industry to point to the plaque he received as a winner and express his sincere gratitude to the EDEM personnel present. "This is an idea I would never have had on my own," he said "the concept and assistance I received will make something I have dreamed about a reality." Congratulations Mr. and Mrs. Radovani!!! ■

International Footwear Reporters Visit Albania

During the last week in May, EDEM and its partner ACIT cooperated in bringing to Albania a group of distinguished journalists representing international footwear industry publications in Italy, France, Finland, and Greece.

The group consisted of:

- Mr. Carlo Ambrogi - ARS Arpel Group, Milan Italy;.
- Mr. Eugenio Di Maria - Shoe Intelligence, Paris France;.
- Mr. Yrjo Gorski - Modin Magazine, Helsinki Finland. Mr. Gorski is also President of the European Confederation of Shoe Retailers; and
- Mrs. Stavy Nicolandi - Dermanea Magazine, Athens Greece.

në Ballkan. Granti do të bënte të mundur që z.Radovanitë lëvronte pjesërisht fonde të veta dhe të fillonte zbatimin e projektit.

EDEM bashkëpunoi me z.Radovani, duke e asistuar në përgatitjen e projekt propozimit dhe shpjegimit në detaje të efektit pozitiv që ky projekt do të kishte për gratë e papuna në Pukë. Faza e parë e projektit ishte konkurrimi me projekte të tjera relevante në Shqipëri. Projekt propozimi ishte bindës në konkurimin në Shqipëri dhe z.Radovani ishte një nga të zgjedhurit, për të konkuruar në nivel rajonal në Beograd. Në konkurimin me 120 projekte nga gjithë Ballkani, BertToni doli një nga 21 kompanitë që Banka Botërore përzgjodhi për përftimin e grantit $35,000!

Gjatë vizitës së gazetarëve të huaj tek BertToni, z.Radovani tregoi trofeun e marrë si fitues i grantit dhe shprehu mirënjohjen e sinqertë për mbështetjen e EDEM. "Nuk do të më kishte shkuar mendja në këtë ide se mund të përfitohet përmes granteve" u shpreh ai "koncepti dhe asistenca që mora po e bëjnë ëndrrën realitet". Urime z. dhe zj.Radovani!!! ■

Gazetarë të Huaj të Këpucëve Vizitojnë Shqipërinë

Footwear reporters during the visit / *Gazetarët gjatë vizitës*

Javën e fundit të majit EDEM dhe partneri i vet, ACIT, bashkëpunuan për sjelljen në Shqipëri të një grupi gazetarësh të mirënjohur që përfaqësojnë botime të huaja për industrinë e këpucëve në Itali, Francë, Finlandë, and Greqi.

The journalists' tour included visits to various footwear manufacturing companies in Tirana, Kruja, Shkodra, Patos, and Vlora. Albanian footwear companies provided tours of their facilities and answered questions about their companies, export markets, and the working conditions in their factories. The group also visited local retail shops and had an opportunity for discussions with USAID officials.

Footwear reporters during the visit / *Gazetarët gjatë vizitës*

Mr. Ambrogi's company also produces fashion publications and operates the world's foremost designer training institute. He made presentations to the companies concerning these and offered special incentives to Albanian companies to obtain his products and services.

"Our eyes were opened to the opportunities in this least known country in Europe," said Mr. Di Maria. "We are grateful for the opportunity to visit Albania and provide information about it to our readers."

The purpose of the visit was to educate the journalists about Albania's footwear industry so the positive and informative articles which result will generate worldwide interest from foreign buyers. Articles from previous efforts have begun appearing in footwear trade publications during 2006. ■

Grupi përbëhej nga:

- Z. Carlo Ambrogi - ARS Arpel Group, Milano, Itali.
- Z. Eugenio Di Maria – Publikimi Shoe Intelligence, Paris, Francë.
- Z. Yrjo Gorski – Revista Modin, Helsinki, Finlandë. Z. Gorski është gjithashtu President i Konfederatës Europiane të Dyqaneve të Këpucëve.
- Zj. Stavy Nicolandi – Revista Dermanea, Athinë, Greqi.

Udhëtimi një javor përfshiu vizita në fabrika të ndryshme të prodhimit të këpucëve në Tiranë, Krujë, Shkodër, Patos, dhe Vlorë. Kompanitë shqiptare i mirëpritën dhe shoqëruan gazetarët gjatë vizitës në ambjentet e punës, si edhe iu përgjigjën pyetjeve të tyre në lidhje me biznesin e tyre, tregjet e eksportit dhe kushtet e punës së punëtorëve në fabrika. Gjithashtu grupi vizitoi dyqane këpucësh dhe pati mundësinë të diskutonte me drejtuesit e USAID.

Kompania e z. Ambrogi boton publikime me tendencat më të fundit në këtë industri dhe ka një institut nga më në zëtë në botë për përgatitjen e dezinjatorëve për këpucë. Ai bëri një prezantim në kompanitë e interesuara dhe ofroi çmime speciale për produkte dhe shërbime që ARS Arpel Group ofron.

"Jemi të çuditur nga oportunitetet që ofron vendi më pak i njohur në Europë," tha z. Di Maria. "Jemi mirënjohës për mundësinë e vizitës në Shqipëri, për t'ua ofruar këtë informacion lexuesve tanë."

Qëllimi i vizitës ishte të sensibilizonte gazetarët e huaj për industrinë e këpucëve në mënyrë që artikuj informativë pozitiv të shkruar prej tyre të ngrenë interesin e blerësve të huaj në mbarë botën. Gjatë vitit 2006 ka pasur edhe artikuj të tjerë për industrinë shqiptare të këpucëve të publikuara në shtypin e huaj të specializuar për këtë industri. ■

Technology and Trends for the Future

Leaders of major footwear manufacturing, marketing, and retailing companies were recently asked for their ideas on trends that would most likely shape the future of the industry over the next 20 years.

Teknologjia dhe Tendencat për të Ardhmen

Prodhues, tregtues dhe kompani shitjesh kryesore në fushën e këpucëve u pyetën së fundmi për tendencat që do të karakterizonin të ardhmen e kësaj industrie në 20 vitet në vijim. Ndërsa parashikimet

While predictions over even 5 years rarely hold true, highlights of their predictions are most interesting:

- Internet sales of footwear will exceed 25% within even 20 years;
- Video conferencing will replace most travel for product development as 3 D form becomes available;
- Robotics will replace many of the manual operations involved in footwear production;
- Children's shoes will have growth indicators to alert parents when it is time for a larger size;
- Shoes will have sensors to adjust a shoe from cold to warm temperatures;
- Shoes will not be so much an art form as people worldwide will dress more and more alike;
- Consolidation will greatly expand. Small companies will be contractors for a few giant footwear producers; and
- Costs will likely be driven even lower due to manufacturing shifts to low wage countries and more economy of scale in production.

While some of these predictions seem far fetched, one can only look at the changes in the last 20 years in the industry and see that these predictions may actually be on the conservative side. ■

edhe për mbi 5 vjet rrallë dalin të vërteta, ato më kryesoret janë interesante:

- Brenda 20 viteve të ardhshme shitjet e këpucëve në internet do të rriten me 25%;
- Komunikimi/mbledhjet on line do të zëvendësojë shumicën e udhëtimeve për zhvillimin e produktit, kur dizaini 3 dimensional të jetë në përdorim;
- Robotët do të zëvendësojnë shumicën e punës me dorë në prodhimin e këpucëve;
- Këpucët e fëmijëve do të shënojnë rritje të treguesve për të përgatitur prindërit kur vjen koha për një numër më të madh;
- Këpucët do të kenë sensorë për ta përshtatur këpucën me temperaturat e ngrohta në ato të ftohta;
- Këpucët nuk do të jenë më aq të modës, pasi njerëzit në të gjithë botën do të vishen edhe më tepër njësoj;
- Konsolidimi do të zgjerohet ndjeshëm. Kompani të vogla do kontraktojnë me pak prodhues gjigandë këpucësh;
- Kostot do të ulen edhe më tepër prej kalimit në vende me paga të ulta dhe më shumë ekonomi të shkallës në prodhim.

Ndërsa disa nga këto parashikime duken të largëta për t'u arritur, mund të kujtojmë ndryshimet që kjo industri ka pësuar në 20 vitet e fundit dhe të vërejmë që këto parashikime aktualisht mund të jenë paksa konservatore. ■

American Shoppers - Quality Is #1 When Buying

Historically American shoppers have a reputation of being more conscious of a product's value than of its quality but maybe that is beginning to change. The results of a survey taken in the Fall of 2005 have just been published and show that the top 4 criteria in a consumer's purchase are:

- Quality 38%
- Price 27%
- Value 22%
- Brand 13%

While 76% of the shoppers surveyed said they looked for a specific brand when shopping, they felt quality was 3 times more important. Consumers pointed out that when they found a brand they liked they go back to it but examine the product closely for fit and feel. The results were near the same for male and female shoppers.

In an interesting finding, men proved to be much more loyal to established brands than women. "Women are absolutely not loyal to footwear brands," said Kimberley Grayson, of Aerosoles, a major woman's retailer and vendor. "Brands need to give women a reason to be loyal."

Some other interesting findings from the survey:

- Consumers believe most footwear advertising is too arrogant. Ads speak more of image and not enough about quality.
- Brands chase fashion trends far too much than keeping a shoe's fit and feel constant from one item to another.
- Vendors lose the brand loyalty of customers by not keeping their distribution within select retailers.

The major finding of this survey gives footwear production and marketing companies an insight into what consumers want in the footwear they purchase - A quality product with the fit and feel they are used to and advertising that takes the time to explain more about the product they are purchasing. While this information was collected in the US, its findings are true in much of the world for mid- to higher price level footwear. ■

Dyqanet Amerikane – Cilësia është 1-shi

Historikisht dyqanet amerikane kanë pasur reputacionin si më të dhëna ndaj vlerës së produktit sesa ndaj cilësisë, por ndoshta kjo po fillon të ndryshojë. Rezultatet e një vëzhgimi të kryer në vjeshtën e vitit 2005 dhe publikuar kohët e fundit tregon katër kriteret kryesore të konsumatorit për blerje:

- Cilësi 38%
- Çmim 27%
- Vlerë 22%
- Markë 13%

Ndërsa 76% e dyqaneve të intervistuara thanë që kërkonin për një markë specifike, ata vlerësuan që cilësia është tre herë më e rëndësishme. Konsumatorët u shprehën që kur gjenin markën e preferuar e blenin përsëri, por pasi e kishin parë me kujdes nëse u rrinte mirë dhe ndjeheshin rehat me të. Rezultatet ishin thuajse të njëjta për dyqanet e këpucëve për gra dhe burra.

Një fakt interesant ishte që meshkujt tregohen më besnik ndaj markave të njohura sesa femrat. "Femrat janë absolutisht jo besnike ndaj markave të këpucëve" shprehet Kimberley Grayson, i Aerosoles, një rrjet i madh dyqanesh me këpucë për femra. "Markat duhet t'u japin femrave arsyen e mjaftueshme për të qenë besnike ndaj tyre".

Disa të dhëna të tjera interesante nga vëzhgimi:

- Konsumatorët besojnë që shumica e reklamimit të këpucëve është tepër arrogante. Reklamat flasin shumë për imazhin dhe jo mjaft për cilësinë.
- Markat ndjekin tendencat e modes, në vend që të jenë konstante nga një produkt tek tjetri për të bërë këpucë të rehatshme dhe që rrinë mirë.
- Tregtuesit e mëdhenjë humbasin besnikërinë e konsumatorit duke mos pasur vazhdimësi në shpërndarje tek dyqanet e zgjedhura.

Rezultatet e këtij vëzhgimi i ofrojnë prodhuesve dhe tregtuesve të këpucëve një ide se çfarë duan konsumatorët kur blejnë këpucë – një produkt cilësor me të cilin janë mësuar, të rehatshëm dhe që u rri mirë dhe reklama që marrin kohë të shpjegojnë më shumë për produktin që ata do të blejnë. Ndërsa ky është informacion i mbledhur në ShBA, rezultatet e tij janë të vërteta kryesisht në gjithë botë për këpucët në nivel çmimi mesatar apo të lartë. ■

TRAINING

Business Service Providers and the Business Community

BSPs are an integral extension of the services that EDEM provides and will become key resources to the business community when EDEM and other donor supported efforts finish their activities in Albania. To help BSPs assisted by EDEM and other USAID efforts connect with the Albania business community, EDEM is organizing showcase events throughout Albania for Albanian BSPs to explain their services to local businesses. Following the events, BSPs with assistance from EDEM will visit individual companies expressing interest in the training and consulting services provided by the BSPs. ■

Training

EDEM supports the development of Albanian BSPs so they can better serve Albanian businesses in management and human resources development, leadership, quality management, marketing, business plan development, financial services, accounting and technology services.

TRAINIME

Ofruesit e Shërbimeve për Bizneset dhe Komuniteti i Biznesit

Ofruesit e Shërbimeve për Bizneset (BSP) janë pjesë integrale e shërbimeve që EDEM ofron dhe do të bëhen burim i rëndësishëm për komunitetin e biznesit kur EDEM dhe projekte të tjera donatore të përfundojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri. Për të ndihmuar BSP-të e asistuara nga EDEM dhe iniciativa të tjera të USAID në lidhje me komunitetin e biznesit, EDEM po organizon në të gjithë vendin aktivitete promocionale, ku BSP-të të shpjegojnë për bizneset lokale, shërbimet që ato ofrojnë. Në vijim, me asistencën e EDEM, BSP-të do të bëjnë vizita individuale në kompani të interesuara të përftojnë shërbime trainimi apo këshillimi të ofruara nga ato. ■

Trainimi

EDEM mbështet zhvillimin e Ofruesve të Shërbimeve për Biznesin Shqiptar (BSP) në mënyrë që ata t'i shërbejnë më mirë bizneseve vendase në manaxhimin e burimeve njerëzore, lidership, manaxhimin e cilësisë, marketing, hartimin e planit të biznesit, shërbimeve financiare, shërbimeve të kontabilitit dhe atyre të teknologjisë. EDEM trainon BSP-të në mënyrë që ato të transferojnë aftësitë e tyre, duke përdorur teknika cilësore trainimi. Disa nga arritjet e fundit përfshijnë:

Seminari i Manaxhimit të Markës për BSP-të

Në maj u organizua nga EDEM një seminar mbi Manaxhimin e Markës, në të cilin u trainuan 12 trainerë dhe konsulentë mbi rëndësisë e rolit të strategjisë së markës në krijimin e planeve të biznesit.

Participants in brand management workshop

EDEM trains the BSPs to transfer skills using quality training techniques. Some recent efforts include:

Brand Management Workshop for BSPs

In May, a Brand Management workshop was organized by EDEM at which 12 BSPs received training in recognition of the importance and role of brand strategy in the creation of business plans. The workshop included the history of Brand Management, explanation of how a brand can add value within a company etc.

An integral part of the workshop training was providing the participants with an opportunity to apply their acquired knowledge to real business situations. The participants, under the guidance of EDEM's branding consultant, worked with three Albanian businesses in helping those businesses outline the steps needed to be taken by the businesses to develop and implement a branding strategy for their respective firms. The sample businesses were EDEM-assisted firms engaged in herbs & spices processing, tourism and mushroom production.

This training course was another service offered by EDEM that BSPs can add to their training package.

IT for accounting and business management

In February, EDEM, in cooperation with an IT technology consulting company and an accounting software development company, provided a workshop on the use of software to 30 business representatives from the Korca Region. Topics covered included accounting software and the advantages of computerized accounting programs. Video conferencing was also featured. Both the IT consultant and the accounting software company have received inquiries requesting offers for their services from local businesses. ■

Seminari përfshinte historinë e manaxhimit të markës, shpjegimin se si një markë mund të shtojë vlera brenda një kompanie, etj.

Pjesë përbërëse e seminarit ishte dhënia e mundësisë pjesëmarrësve për të aplikuar njohuritë e përftuara në situata reale biznesi. Pjesëmarrësit, nën drejtimin e konsulentëve të markës nga EDEM, punuan me tre biznese shqiptare, duke i ndihmuar ato në përcaktimin e hapave që duhen ndërmarrë për zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë së markës në kompanitë e tyre përkatëse. Bizneset e marra si shembull ishin firmat që asistohen nga EDEM dhe që operojnë në fushat e përpunimit të bimëve aromatiko-mjekësore, turizmit dhe prodhimit të kërpudhave.

Ky kurs trainimi ishte një tjetër shërbim i ofruar nga EDEM, që Ofruesit e Shërbimeve për Biznesin mund ta shtojnë në paketën e tyre të trainimeve.

Teknologjia e Informacionit për Manaxhim Biznesi dhe Programe Financiare

